



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:303263
Datë: 30.08.2024
Numri i dokumentit: 06103075

K.DH.SHK.II.1473/24

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryetar, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit MTS SHPK me NUI 71206742 me seli në adresën Rr. Boshnjaqaka Mahala Oslobogjenje, nr. 1 Mitrovica e Veriut e përfaqësuar nga D.O., kundër të paditurit Autoritetit të Konkurrencës, me bazë juridike, anulimi i aktvendimit me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues të paditurës Nr. 120/23 të datës 18.12.2023, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit-paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Administrativ, nr. KA.nr.591/23 të datës 05.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues MTS SHPK me NUI 71206742 me seli në adresën Rr. Boshnjaqaka Mahala Oslobogjenje, nr. 1 Mitrovica e Veriut, ndërsa Aktvendimit i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Administrativ, nr. KA.nr.591/23 të datës 05.06.2024, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Administrativ, është refuzuar propozimi i paditësit-propozuesit MTS SHPK me NUI 71206742 për caktimin e masës së përkohshme-pezuillimin e ekzekutimit të vendimit të paditurës, Nr. 120/23 të datës 18.12.2023 të Autoritetit të Konkurrencës deri në vendim përfundimtar të gjykatës, si i pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi, me propozim që gjykata të aprovoj ankesën si të bazuar, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë si dhe të aprovohet në tersi si e bazuar kërkesa e paditësit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit Nr. 120/23 të datës 18.12.2023 deri në një vendim përfundimtarë gjyqësorë sipas padisë së paditësit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenit 194 të LPK-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të paditurës, Nr. 120/23 të datës 18.12.2023, ka gjetur se propozimi i tillë është i pabazuar, ngase paditësi, nuk e ka bërë të besueshme pretendimin e tij, se me ekzekutimin e vendimit të paditurit, i njëjti do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohet dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, për të shtyrë pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të kontestuar. Andaj, gjykata gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par. 6 lidhur me parag.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenin 27 prag. 1 të ligjit nr. 08/L-015, për Gjykatën Komerciale. Tutje gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se, se paditësi nuk ka dorëzuar prova të mjaftueshme për të bërë të besueshëm pretendimin për pamundësinë e përmbushjes (sipas nenit 57 të LMK-së) në mënyrë gjykata të vlerësoj fuqinë financiare të propozuesit për të përmbushur obligimin ndaj kundër propozuesit, konform nenit 319.1 të LPK-se ku përcaktohet secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta. Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi nuk ka bashkangjitur Raport financiar bankar për të dëshmuar qarkullimin e përgjithshëm në vitin e fundit, i cili raport nuk duhet të kufizohet vetëm në qarkullimin -e vjetor në Republikën e Kosovës por duhet të dëshmohet me Raporte financiare bankare nga të gjitha vendet në të cilat operon (siç kërkohet konform nenit 57 të Ligi për Mbrojtjen e Konkurrencës) e që sipas arsyetimit të vendimit të kundërshtuar rezulton që Paditësi MTS Sh.p.k në Republikën e Serbisë për vitin 2022 ka realizuar qarkullim në vlerë 983,859,968.64€.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshme qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi me ankesën e ushtruar kërkon që të ndalohej ekzekutimi i aktvendimit Nr. 120/23 të datës 18.12.2023, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes nga gjykata.

Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të propozuesit- paditësit, në ankesë, të cekura më gjerësisht si në ankesë, ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se te njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit, është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së, sepse, kërkesa ne tersi është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar pretendimet e propozuesit-paditësit për shtyrje te ekzekutimit, ne drejtim te arsytimit për shtyrje te ekzekutimit vendimit kontestuese, me te cilin ka deklaruar se me ekzekutimin e këtij vendimi, propozuesit- paditësit do ti shkaktohen dem i pariparuar. Propozuesi në kërkesën për caktimin e masës së përkohshme, nuk ka dëshmuar se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i pariparueshëm, se ekziston rreziku i shkakimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet masa e përkohshme. Rrjedhimisht nuk ka ofruar as fakte dhe dëshmi se ekziston mundësia e shkakimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye caktimi i masës të përkohshme është i domosdoshëm. Demi konsiderohet i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund te zhdëmtohet ne mënyre te arsyeshme me ane te një kompensimi financiar. Kërkesën për shtyrje duhet argumentuar mbi baza reale të shkakimit të dëmit të pariparueshëm, vlera e të cilit është e pa kompensueshme në kuptimin material.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji gjene se, Aktvendimit i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Administrativ, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsytimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SHK.II.nr.1473/24 me datë 28.08.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi